



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 44 dt.30.04.1996

Këshilli Bashkiak Tiranë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Zyra e Administratës, Drejtoria Administrimit Financiar dhe Zyrës Juridike, lidhur me fondin e nevojshëm për pagesën e qerasë së ambjenteve në godinat private të familjeve Kasmi dhe Theothosi, që përdorën nga Bashkia e Tiranës për nevojat e saj, si dhe duke u bazuar në vendimet e Gjykatës së Rrethit të Tiranës Nr.6073, dt.21.09.1995 dhe Nr.5271, dt.15.08.1995 për tarifat e qerasë.

**VENDOSI**

1. Të çelet fondi mujor i qerasë për familjen Kasmi për 5.868 USD (me kusin zyrtar të lekut) duke filluar nga 1 Janar 1996 pagesë e cila do të bëhet sipas akt – marrëveshjes në mes të Bashkisë së Tiranës dhe familjes Kasmi. Për pagesën përpara kësaj periudhe do të vendoset pas shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje ligjshmërie nga Gjykata e Kasacionit.
2. Të çelet fondi mujor i qerasë për familjen Theothosi për 55.120 lekë duke filluar nga data 15.11.1995. Mënyra e kësaj pagese të rregullohet me akt – marrëveshje në mes të Bashkisë së Tiranës dhe familjes Theothosi.
3. Fondi për likuidimin e qerasë do të përballohen nga fondet e Bashkisë.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Administratës, Zyra Juridike dhe Drejtoria Administrimit Financiar.
5. Ky vendim hyn në fuqi nga data e marrjes së pronësisë për të dy familjet(Kasmi dhe Theothosi). Pretendimet e Bashkisë për ujen e masës së pagesës së qerasë nëpërmjet gjygjtit le të vazhdojë. Vazhdimi i procesit gjygjësor të mos pengojë dhënien e pagesës.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**